



**REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVO**  
**KUVENDI I KOMUNES - SKUPŠTINA OPŠTINE**  
**DRAGASH - DRAGAŠ**  
**ZYRA PËR PROKURIM – KANCELARIJA ZA JAVNU NABAVKU**

Zyra per prokurim ne Dragash, ne baze te kerkeses per rishqyrtim te bere me date 23.02.2021 nga OE "Geo-Map" -Prishtine , ne lidhje me aktivitetin e Prokurimit me nr: 621-21-60-221 " Hartimi I projekteve per nevojat e Komunes se Dragashit per 24 muaj " duke u bazuar ne Rregullat qe adoptojne,plotesojne dhe japin sqarime per paraqitje te kerkeses per rishqyrtim prane Autoriteteve Kontraktuese,parashtrim te ankesave prane OSHP-se dhe vlera e tarifave te ankesave si dhe duke u bazuar ne nenin 8.1.1 te kesaj rregulloreje-te aprovuara nga Komisioni Rregullativ I Prokurimit Publik I cili ne pajtim me Nenin 87,paragrafi 2,nenin paragrafin 2.8 dhe nenin 118,paragrafi 1,te Ligjit mbi prokurimin Publik nr.04/L-042,I ndryshuar dhe plotesuar me ligjin nr.04/L-237,ligjin nr.05/L-068 dhe ligjin nr.05/L-092, bjen kete :

### **V E N D I M**

- 1. Refuzohet kerkesa e OE "Geo-Map" -Prishtine e propozuar per rishqyrtim si e pa baze**
- 2. AK vendos te vazhdoj sipas Njoftimit mbi Vendimin e AK per dhenie te kontrates te publikuar me date 18.02.2021.**

### **A R S Y E T I M**

Lidhur me kerkesen tuaj per rishqyrtim te vendimit, Autoriteti Kontraktues konstaton se pretendimet tuaja jane te paqendrueshme jo te sakta dhe te pa bazuara ne LPP per arsyet si me poshte:

**Ne pretendimin nr. 1 :**



**REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVO**  
**KUVENDI I KOMUNES - SKUPŠTINA OPŠTINE**  
**DRAGASH - DRAGAŠ**  
**ZYRA PËR PROKURIM – KANCELARIJA ZA JAVNU NABAVKU**

Ku thuhet se OE I rekomanduar me kontrate nuk posedon dokumentacionin sipas kerkeses ne dosje te tenderit a) Inxhinier I diplomuar I elektroteknikes-dega telekomunikacion, pasi qe eshte dorezuar vetem çertifikata e diplomes se Inxhinierit,nuk qendron pasi qe e njejta e ka dorezuar kete çertifikate ku shkruhet se ka diplomuar me date 21.09.2004, gjithashtu edhe ne diplomen e ofruar pas kerkeses per sqarim te bere per kete document shume qarte shihet se me daten e njejte ka diplomuar. Ndersa sa I perket asaj se diploma I eshte leshuar me date 21.02.2021 kjo nuk paraqet kurrfare problem pasi qe ne kete kohe vetem se e ka kerkuar me u pais me kete document. Çertifikata e diplomes eshte document I barasvlefshem dhe ekuivalent me diplomen, prandaj ky pretendim nuk qendron.

**Ne pretendimin nr, 2:**

Ku thuhet se OE I rekomanduar me kontrate nga AK ka prezantuar nje Inxhinier ne stafin e tij si punetor ,I njejti eshte I prezantuar edhe ne nje Operator tjetër Ekonomik. Edhe ky pretendim nuk qendron pasi qe nuk parashihet se nje punetor I angazhuar ne nje ndermarrje nuk mund te angazhohet diku tjetër.

**Ne pretendimin nr, 3 :**

Ku thuhet se OE I rekomanduar me kontrate nuk ka ofruar deshmin e kerkuar, nje Vertetim te leshuar nga Gjykata kompetente(kopje), dhe nje Vertetim te leshuar nga Administrata Tatimore e vendit te themelimit te OE ( kopje), edhe ky pretendim nuk qendron pasi e njejta I ka dorezuar qe te dya keto dokumenta.Ndersa per OE ankues nuk parashihet qasje per keto dy dokumenta pasi qe te njejtat kerkohen vetem per OE te rekomanduar per kontrate para dates se nenshkrimit te kontrates.

Prandaj edhe nje here konstatojm se pretendimet tuaja ankimore nuk qendrojne dhe se:

Ne fund vendoset si ne dispozitiv te ketij vendimi.

**Keshilla juridike:** Pala e pa kenaqur sipas nenit 109 te ketij Ligji,mund te ankohet ne Organin Shyrtues te Prokurimit Publik te Kosoves ne afat prej 10 ditesh,nga marrja e ketij vendimi .

**Dragash 25.02.2021**

**zyrtari pergjegjes per prokurim**

**Nuro Ismaili**